



OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOŠA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 1632 Dt. 13/10/2020
PRISHTINË - A

PROCEDURË PËR SHKËMBIMIN DHE AKTIVIZIMIN E REZERVAVE PËR BALANCIM TË ZONAVE RREGULLUESE DHE BLLOKUT AK

Prishtinë – Tiranë

2020

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	3
2.	Qëllimi dhe fusha e zbatimit	3
3.	Shkurtesat	4
4.	Përgjegjësitet e OST dhe KOSTT	5
5.	Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Mbajtjes se Frekuencës - FCR	5
6.	Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Restaurimit Automatik të Frekuencës - aFRR	5
7.	Shlyerja financiare e aktivizimit të aFRR	7
8.	Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Restaurimit Manual të Frekuencës - mFRR	9
9.	Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR modeli TSO-POSH	11
10.	Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR modeli TSO-TSO	13
11.	Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Zëvendësimit - RR	15
12.	Shkëmbimi i informacioneve për aktivizimin e aFRR:	15
13.	Shkëmbimi i informacionit për aktivizimin e mFRR	16
14.	Mbajtja e parametrave të FRCE sipas targeteve të vendosura për bllokun LFC	17
15.	Masat e mëtejshme me qëllim të zvogëlimit të FRCE	19
Shtojca 1	Sigurimi dhe aktivizimi i rezervave për balancim të sistemit	21
Shtojca 2	Shkëmbimi i informacioneve për aktivizimin e rezervës manuale të operimit ...	38
Shtojca 3	Mbajtja e parametrave të FRCE sipas targeteve të vendosura për bllokun	40
Shtojca 4	Skenarët në rast të harxhimit të rezervës	42

1. Hyrje

1.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Kosovës (KOSTT), duke marrë parasysh nevojën për implementimin e:

- a) Marrëveshjes së Bllokut AK;
- b) Marrëveshjes KOSTT-OST- Ofrimi i Shërbimeve Të Rregullimit Sekondar.

Nevojës për përmbushjen e obligimeve që dalin nga:

- a) Udhëzuesi i Operimit të Sistemit (SO GL) Neni 128;
- b) Rregullorja për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Kongestionit neni 2;
- c) Kodi i Rrjetit për Restaurimin e Emergjencave;
- d) Udhëzuesi për Balancimin e Energjisë Elektrike;

zhvillojnë këtë procedurë për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave.

1.2. Kjo procedurë do të dërgohet për dijeni në ERE dhe miratim në ZRRE.

2. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

- 2.1. Kjo procedurë definon përgjegjësitë e KOSTT dhe OST dhe hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për aktivizimin e rezervave FCR – Rezerva e Mbajtjes së Frekuencës, aFRR – Rezerva e Restaurimit Automatik të Frekuencës dhe mFRR – Rezerva e Restaurimit manual të Frekuencës dhe RR – Rezerva Zëvendësuese.
- 2.2. Kjo procedurë përcakton parimet për balancimin e zonave LFC të KOSTT dhe OST dhe bllokut LFC AK, duke përfshirë krijimin e parimeve të përbashkëta për prokurimin dhe aktivizimin e rezervave të rregullimit të frekuencës, rezervat e restaurimit të frekuencës dhe rezervat e zëvendësimit.
- 2.3. Procedura do të përdoret nga zona LFC OST dhe KOSTT për balancimin e zonave LFC përkatëse dhe bllokut LFC AK.

3. Shkurtesat

Shkurtesa	Përshkrimi
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemeve Transmetuese për Energji Elektrike.
CE	Evropa Kontinentale (Continental Europe)
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës.
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
ERE	Enti Rregulator i Energjisë
OS	Operatori i Sistemit
OST	Operatori i Sistemit Transmetues të Shqipërisë
SOGL	Udhëzuesi i Operimit të Sistemit
FCR	Rezerva e Mbajtjes së Frekuencës
aFRR	Rezerva e Restaurimit Automatik të Frekuencës
mFRR	Rezerva e Restaurimit Manual të Frekuencës
RR	Rezerva e Zëvendësimit
FCRE	Gabim i Restaurimit të Kontrollit të Frekuencës
TSO	Operator i Sistemit të Transmetimit
TSO MR	TSO Marrëse e Rezervës
TSO LR	TSO Lidhëse e Rezervës
POSH	Pala ofruese e shërbimit të balancimit ose TSO Lidhëse e Rezervës
VTL	Linje virtuale ndërkufitare që përdoret për qellim të akountingut për qëllim të shkëmbimit të rezervave ndërkufitare në kohe reale për aFRR dhe mFRR
LFC	Kontrolli Fuqi-Frekuencë

4. Përgjegjësitet e OST dhe KOSTT

- 4.1. KOSTT dhe OST duhet të pajisin monitoruesin e bllokut LFC me matjet e Zonës LFC përkatëse, të nevojshme për grumbullimin e të dhënave për vlerësimin e kualitetit të frekuencës për bllokun LFC.
- 4.2. Monitoruesi i bllokut LFC duhet t'u dorëzoje OST dhe KOSTT të dhënrat për vlerësimin e kualitetit të frekuencës për bllokun LFC AK dhe për zonën LFC të tyre, një herë në tre muaj.

5. Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Mbajtjes se Frekuencës - FCR

- 5.1. Rezerva e Mbajtjes së frekuencës (FCR) është ajo rezervë që aktivizohet automatikisht në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara. Rezerva aktivizohet plotësisht brenda 30 sec, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 minuta.
- 5.2. FCR është e detyrueshme për të gjitha njësitet gjeneruese të lidhura në sistemin e transmetimit të OST dhe KOSTT.

6. Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Restaurimit Automatik të Frekuencës - aFRR

- 6.1. Secili operator i sistemit transmetues në bllokun LFC AK duhet në mënyrë të pavarur të implementoj procesin e restaurimit automatik të frekuencës (aFRR), aFRR i seilës Palë duhet të përcaktohet në atë mënyrë që të zgjedhoj vetëm FRCE të TSO-së përkatëse.
- 6.2. Prokurimi i aFRR që përcaktohet për seilën palë, bëhet në mënyrë të pavarur, pra OST dhe KOSTT prokurojnë rezervën përkatëse, seila për zonën e vet LFC.
- 6.3. Vlera e aFRR për zonat LFC OST dhe KOSTT do të vlerësohet periodikisht. Të dy TSO-të synojnë të optimizojnë angazhimin e rezervës dhe kostot e rezervës përmes procesit të netimit të disbalancave në momentin kur të krijohen kushtet teknike dhe platforma përkatëse.
- 6.4. Sigurimi i rezervave automatike për zonat LFC mund të bëhet brenda zonës LFC dhe jashtë zonës LFC, brenda bllokut LFC AK dhe jashtë bllokut LFC AK.
- 6.5. Në rastin kur rezerva sigurohet jashtë zonës LFC por brenda bllokut LFC AK atëherë mënyra e aktivizimit të rezervës bëhet në dy mënyra: TSO – POSH dhe TSO - TSO.

- 6.6. Në rastin kur është e nevojshme përdorimi i aFRR të prokuruar nga pala tjetër, atëherë do të përdoret modeli TSO – TSO sipas të cilit TSO MR , i adresohet TSO LR.
- 6.7. Në rastin kur furnizuesi POSH ndodhet në zonën LFC të palës tjetër, atëherë do të përdoret modeli TSO – POSH sipas të cilit TSO MR i kërkon POSH aktivizimin e rezervës.
- 6.8. Në situata të jashtëzakonshme njëra Palë do të kërkojë nga Pala tjetër që të realizojë aFRR në emër të palës së ndikuar, në mënyrë që të zgjedhë FRCE e bllokut LFC AK, Pala e ndikuar duhet të bëjë përpjekje që të zgjedhë FRCE të bllokut LFC AK.
- 6.9. Rezerva e restaurimit automatik të frekuencës (aFRR) përdoret (në mënyrë automatike) në rast të devijimit të frekuencës nga vlera nominale dhe/ose të balancës së shkëmbimit nga vlera e nominuar. Kjo rezervë vendoset në gjeneratorët rregullues të destinuar për këtë qëllim.
- 6.10. Përditësimi i kërkesës për rregullim automatik do të bëhet në kohë reale përmes AGC në sistemet SCADA EMS. Sasia do të definohet sipas nevojës por brenda kufirit të definuar në marrëveshje për këtë shërbim.
- 6.11. Ky shkëmbim (eksport/import) do të realizohet nëpërmjet linjës virtuale të krijuar enkas për këtë qëllim. Linja virtuale duhet të jetë e regjistruar me kodin EIC përkatës për këtë qëllim.
- 6.12. Energia e cila do të regjistrohet në Linjën virtuale do të përdoret për qëllim të korrigjimit ex-post të FRCE dhe Shlyerjes financiare.
- 6.13. Për aktivizimin ndërkufitar të rezervës automatike duhet të jenë në dispozicion kapacitetet transmetuese ndërkufitare ndërmjet zonës LFC KOSTT dhe OST.
- 6.14. Të dy TSO-të e bllokut LFC AK duhet të mbajnë sasinë e aFRR së paku në të njëjtin nivel sikurse në vitin paraprak.
- 6.15. Procedura përshkruan të gjitha mundësitë e shkëmbimit të rezervës aFRR në përputhje me udhëzuesin SOGL. Për shfrytëzimin e të gjitha mundësive të shkëmbimit të aFRR, TSO-të duhet të zhvillojnë platformat e nevojshme. Për momentin sipas platformave të zhvilluara nga TSO-të mund bëhet vetëm shkëmbimi i rezervës aFRR sipas modelit TSO-TSO.

7. Shlyerja financiare e aktivizimit të aFRR

- 7.1. Shlyerja (Barazimi) financiare për aktivizimin e aFRR do të bëhet për kapacitetin rezervë të vënë në dispozicion dhe për energjinë balancuese të angazhuar.
- 7.2. Shlyerja financiare e aktivizimit të aFRR do të bëhet për periodën kohore të Shlyerjes 15 minuta (çerek ore).
- 7.3. Kompensimi për aktivizimin e aFRR do të bëhet në baza mujore për kapacitetin rezervë të vënë në dispozicion dhe kompensimi për energjinë e angazhuar.
- 7.4. Kompensimi për kapacitetin e rezervuar aFRR bëhet si në vijim.

7.4.1. Kompensimi për kapacitetin ngritës aFRR:

$$Pagesa_{K_{aFRR_Ngritës}} = K_{R_{aFRR_Ngritës}} * \zeta_{K_{aFRR_Ngritës}}$$

Ku :

$K_{R_{aFRR_Ngritës}}$ Kapaciteti i rezervuar sipas kontratës me POSH;

$\zeta_{K_{aFRR_Ngritës}}$ Çmimi për kapacitetin rezervë sipas kontratës me POSH.

7.4.2. Kompensimi për kapacitetin zbritës aFRR:

$$Pagesa_{K_{aFRR_Zbritës}} = K_{R_{aFRR_Zbritës}} * \zeta_{K_{aFRR_Zbritës}}$$

Ku :

$K_{R_{aFRR_Zbritës}}$ Kapaciteti i rezervuar sipas kontratës me POSH;

$\zeta_{K_{aFRR_Zbritës}}$ Çmimi për kapacitetin rezervë sipas kontratës me POSH.

- 7.5. Kompensimi për energjinë e aktivizuar aFRR do të bëhet në baza mujore sipas çmimit të kontraktuar të energjisë elektrike që mund të jetë çmim i bazuar në treg balancues apo çmim i Mekanizmit Balancues në fuqi.

7.5.1. Llogaritjet për Kompensimin e energjisë së aktivizuar aFRR për rregullimin ngritës do të bëhen në baza kohore prej $t=4$ sec të cilat agregohen në periodën Shlyerjes 15 minuta.

A. Rregullimin ngritës aFRR.

a. Llogaritjet për periodën t=4 sec:

$$P_{A_{aFRR_Ngritës}} * \zeta_{A_{aFRR_Ngritës}}$$

Ku :

$$P_{A_{aFRR_Ngritës}}$$

Fuqia e kërkuar për rregullimin ngritës sipas kontratës me POSH apo TSO LR në baza kohore t=4sec [MW];

$$\zeta_{A_{aFRR_Ngritës}}$$

Çmimi për energjinë e aktivizuar të rregullimit ngritës sipas kontratës me POSH apo TSO LR në [€/MWh].

b. Llogaritjet për periodën e Shlyerjes 15 minuta dhe shprehet në €:

$$\frac{\sum_{t=1}^{225} P_{A_{aFRR_Ngritës}(t_i)} * \zeta_{A_{aFRR_Ngritës}}}{15 * 60}$$

Ku :

$$P_{A_{aFRR_Ngritës}(t_i)}$$

Fuqia e kërkuar për ngritje [MW] në intervalin 4 sec.

B. Rregullimin zbritës aFRR.

a. Llogaritjet për periodën t=4 sec:

$$|P_{A_{aFRR_Zbritës}}| * \zeta_{A_{aFRR_Zbritës}}$$

Ku :

$$P_{A_{aFRR_Zbritës}}$$

Fuqia e kërkuar aFRR për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH apo TSO LR në baza kohore t=4 sec [MW];

$$\zeta_{A_{aFRR_Zbritës}}$$

Çmimi për energjinë e aktivizuar aFRR të rregullimit zbritës sipas kontratës me POSH apo TSO LR në [€/MWh].

b. Llogaritjet për periodën e Shlyerjes 15 minuta dhe shprehet në €:

$$\frac{|\sum_{t=1}^{225} P_{A_{aFRR_Zbritës}(t_i)}| * \zeta_{A_{aFRR_Zbritës}}}{15 * 60}$$

Ku :

$$P_{A_{aFRR_Zbritës}(t_i)}: \text{ Fuqia e kërkuar për zbritje [MW] ne intervalin 4 sec.}$$

7.5.2. Kompensimin i POSH apo TSO LR për energjinë e aktivizuar do të bëhet në € për muajin përkatës si shumë e të gjitha periodave të Shlyerjes 15 minuta për atë muaj.

a. Kompensimi për rregullimin ngritës aFRR:

$$Pagesa_{R_{aFRR_Ngritës}} = \sum_j \left(\frac{\sum_{t=1}^{225} P_{A_{aFRR_Ngritës}(t_i)} * \zeta_{A_{aFRR_Ngritës}}}{15 * 60} \right)$$

b. Kompensimi për rregullimin zbritës aFRR:

$$Pagesa_{R_{aFRR_Zbritës}} = \sum_j \left(\frac{|\sum_{t=1}^{225} P_{A_{aFRR_Zbritës}(t_i)}| * \zeta_{A_{aFRR_Zbritës}}}{15 * 60} \right)$$

7.6. Një kompensim (pagesë) me vlerë pozitive për rregullimin ngritës korrespondon me një pagesë për POSH apo TSO LR nga TSO MR, ndërsa një kompensim me vlerë pozitive për rregullimin zbritës korrespondon me një pagesë për TSO MR nga POSH apo TSO LR dhe anasjelltas kur kompensimi (pagesa) është me vlerë negative.

8. Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Restaurimit Manual të Frekuencës - mFRR

- 8.1. Dimensionimi i rezervës manuale të bllokut LFC AK bëhet sipas metodës së dimensionimit të përbashkët dhe kështu përcaktohet rezerva që duhet të prokurohet nga secila palë. Sasia që duhet të sigurohet nga secila TSO është dhënë në shtojcën 1.
- 8.2. Prokurimi i mFRR që përcaktohet për secilën palë, bëhet në mënyrë të pavarur, pra OST dhe KOSTT prokuojnë rezervat përkatëse, secila për zonën LFC të veten.
- 8.3. Në rastin kur njëra TSO ka nevojë për aktivizimin e plotë të rezervës së bllokut LFC AK për shkak të disbalancit të lartë atëherë aktivizimi bëhet TSO – POSH dhe TSO -TSO. Aktivizimi TSO - TSO bëhet për pjesën e rezervës së domosdoshme për balancimin e zonës LFC që është në disbalancë dhe balancimin e bllokut LFC AK.
- 8.4. Në rastin e përdorimit të mFRR të prokuruar nga pala tjetër, atëherë do të përdoret modeli TSO – TSO, sipas të cilit TSO MR i adresohet TSO LR, me kërkesën me shkrim për përdorimin e mFRR duke specifikuar kapacitetin dhe kohëzgjatjen e livrimit të rezervës.

8.5. Rregullat për aktivizimin e mFRR.

- 8.5.1. TSO LR dhe POSH duhet të aktivizojë njësitë gjeneruese pas kërkesës së TSO MR.
- 8.5.2. TSO MR mund të kërkojë aktivizimin e pjesshëm apo në tërësi të kapacitetit të deklaruar nga POSH dhe TSO LR.
- 8.5.3. Kapaciteti i aktivizuar mund të ndryshojë në perioda çerek ore (15 minuta) me kërkese të TSO MR.
- 8.5.4. Kapaciteti i vënë në dispozicion duhet të aktivizohet në një periodë kohore deri në 15 minuta nga momenti i njoftimit nga TSO MR.
- 8.5.5. Numri i aktivizimeve nuk është i limituar për periodën e aktivizimit.
- 8.5.6. TSO MR ka të drejtë të kërkojë aktivizimin e mFRR për një periodë kohore deri në 4 orë në ditë.
- 8.6. Përditësimi i skedulit (programit të shkëmbimit) të furnizuesit POSH do të bëhet nga TSO LR dhe gjithashtu përditësimi i programit të shkëmbimit nga TSO MR.
- 8.7. Ky shkëmbim (eksport/import) do të realizohet nëpërmjet linjës virtuale të krijuar enkas për këtë qëllim.
- 8.8. TSO MR në rastin e modelit TSO - TSO do të mbuloj të gjitha shpenzimet që i janë shkaktuar TSO LR, sipas termave dhe kushteve të prokurimit të rezervës.
- 8.9. Në rastin kur furnizuesi POSH ndodhet në zonën LFC të palës tjetër, atëherë do të përdoret modeli TSO – POSH, sipas të cilit TSO MR i kërkon POSH aktivizimin e rezervës duke specifikuar kapacitetin dhe kohëzgjatjen e livrimit, dhe njëkohësisht njofton TSO LR.
- 8.10. Me konfirmimin e POSH për gatishmërinë e livrimit, ku specifikohet centrali/aggregatet që do të aktivizohen për livrimin e rezervës, vazhdon e njëjta procedurë si në rastin e modelit TSO – TSO.
- 8.11. Në marrëveshjen TSO MR – POSH duhet të specifikohet që livrimi i mFRR nuk mund të bëhet me aggregatet që janë të angazhuar me aFRR dhe mFRR për llogari të TSO LR.

- 8.12. Për Energjinë e konfirmuar për livrim nga POSH për TSO MR do të njoftohet TSO LR për kohën dhe sasinë e energjisë që duhet livruar. Konfirmimi i energjisë së livruar nga POSH për TSO MR dhe të konfirmuar nga TSO LR do të futet në programin e kontrollit të se cilës zonë LFC ex-post me accounting mes KOSTT – OST përmes VTL.
- 8.13. Aktivizimi i rezervës ndërkufitare do të bëhet vetëm nëse ka kapacitete paraprakisht të alokuara për këtë qëllim ose kapaciteteve të lira ndërkufitare ndërmjet OST - KOSTT.
- 8.14. TSO MR do ta informojë liderin e bllokat LFC AK (OST) për kapacitetet e lira interkonektive dhe do të azhurnoj në çdo moment ndryshimin e kapaciteteve ndërkufitare për shkak të alokimit të këtij kapaciteti gjatë ditës në kohë reale.
- 8.15. Kapaciteti ndërkufitar ndërmjet KOSTT – OST do të përdoret për rezervën mFRR pavarësisht cila palë disponon me kapacitetin e lirë.
- 8.16. Në rast të disbalancit ndërmjet energjisë se matur dhe energjisë së dakordësuar për aktivizim nga POSH, kjo disbalancë do të trajtohet si disbalancë në zonën LFC ku operon POSH.
- 8.17. Në rast se disbalanca e krijuar nga POSH nga njësitë e angazhuara për livrimin e mFRR është më e madhe se 10% e kapacitetit të dakordësuar ndërmjet palëve dhe zgjatet për më shumë se 30 minuta, atëherë TSO LR njofton POSH dhe TSO MR për këtë disbalancë. Në rast se vazhdon e njëjtë situatë, pra nuk merren masa për të respektuar programin e dakordësuar, TSO LR ka të drejtë të reduktojë kapacitetin e mFRR duke njoftuar më parë TSO MR dhe POSH.

9. Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR modeli TSO-POSH

- 9.1. Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR do të bëhet për periodë kohore të Shlyerjes të definuar me rregullat në fuqi.
- 9.2. Kompensimi për aktivizimin e mFRR që TSO MR do ti bëjë POSH do të kryhet në baza mujore për kapacitetin rezervë të vënë në dispozicion.
- 9.3. TSO MR do të kompensojë POSH për energjinë e angazhuar për rregullimin ngritës ndërsa POSH do të kompensojë TSO MR për Energjinë e angazhuar për rregullimin Zbritës, kjo vlen kur çmimi i ofertës është me vlerë pozitive ndërsa anasjelltas nëse çmimi i ofertës është me vlerë negative.

9.4. Kompensimi për kapacitetin e rezervuar bëhet si në vijim:

9.4.1. Kompensimi për kapacitetin ngritës mFRR:

$$Pagesa_{K_{mFRR_Ngritës}} = K_{R_{mFRR_Ngritës}} * \zeta_{K_{mFRR_Ngritës}}$$

Ku :

$K_{R_{mFRR_Ngritës}}$	Kapaciteti i rezervuar sipas kontratës me POSH;
$\zeta_{K_{mFRR_Ngritës}}$	Çmimi për kapacitetin rezervë sipas kontratës me POSH.

9.4.2. Kompensimi për kapacitetin zbritës mFRR:

$$Pagesa_{K_{mFRR_Zbritës}} = K_{R_{mFRR_Zbritës}} * \zeta_{K_{mFRR_Zbritës}}$$

Ku :

$K_{R_{mFRR_Zbritës}}$	Kapaciteti i rezervuar për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH;
$\zeta_{K_{mFRR_Zbritës}}$	Çmimi për kapacitetin rezervë për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH.

9.5. Kompensimi për energjinë e aktivizuar mFRR do të bëhet në baza mujore sipas çmimit të kontraktuar të energjisë elektrike që mund të jetë çmim i bazuar në treg balancues apo çmim i Mekanizmit Balancues në fuqi:

a. Rregullimin ngritës mFRR.

Aktivizimi brenda një periodë të Shlyerjes (j):

$$E_{L_{mFRR_Ngritës(j)}} = \sum_n \frac{K_{A_{mFRR_Ngritës(n)}} * t_{(n)}}{60}$$

$$Pagesa_{R_{mFRR_Ngritës}} = \sum_j E_{L_{mFRR_Ngritës(j)}} * \zeta_{E_{mFRR_Ngritës(j)}}$$

Ku :

$E_{L_{mFRR_Ngritës}}$	Energja e livruar gjatë aktivizimit të rregullimit ngritës gjatë një periodë të Shlyerjes (j);
$K_{A_{mFRR_Ngritës}}$	Kapaciteti i aktivizuar për rregullimin ngritës sipas kontratës me POSH;

$\zeta_{E_{mFRR_Ngritës}}$	Çmimi i energjisë për kapacitetin e aktivizuar për rregullimin ngritës sipas kontratës me POSH;
n	Numri i aktivizimeve gjatë një periode të Shlyerjes;
$t_{(n)}$	Kohëzgjatja e një aktivizimi brenda periodës së Shlyerjes (j);
j	Numri i periodave të Shlyerjes në muaj në të cilat ka pasur aktivizim të mFRR.

b. Rregullimin zbritës mFRR.

Aktivizimi brenda një periode të Shlyerjes (j):

$$E_{L_{mFRR_Zbritës(j)}} = \sum_n \frac{K_{A_{mFRR_Zbritës(n)}} * t_{(n)}}{60}$$

$$Pagesa_{R_{mFRR_Zbritës}} = \sum_j E_{L_{mFRR_Zbritës(j)}} * \zeta_{E_{mFRR_Zbritës(j)}}$$

Ku :

$E_{L_{mFRR_Zbritës}}$	Energjia e livruar gjatë aktivizimit të rregullimit zbritës gjatë një periode të Shlyerjes (j);
$K_{A_{mFRR_Zbritës}}$	Kapaciteti i aktivizuar për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH;
$\zeta_{E_{mFRR_Zbritës}}$	Çmimi i energjisë për kapacitetin e aktivizuar për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH;
n	Numri i aktivizimeve gjatë një periode të Shlyerjes (j);
$t_{(n)}$	Kohëzgjatja e një aktivizimi brenda periodës së Shlyerjes (j);
j	Numri i periodave të Shlyerjes në muaj në të cilat ka pasur aktivizim të mFRR.

10. Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR modeli TSO-TSO

- 10.1. Shlyerja financiare e aktivizimit të mFRR do të bëhet për periodë kohore të Shlyerjes të definuar me rregullat në fuqi.

- 10.2. Kompensimi për kapacitetin e rezervuar dhe energjinë e aktivizuar mFRR do të bëhet në baza mujore sipas çmimit të kontraktuar të kapacitetit të rezervuar dhe çmimit të energjisë për kapacitetin e aktivizuar që TSO LR ka me POSH (çmim i bazuar në treg balancues apo çmim Mekanizmit Balancues në fuqi të TSO LR):

c. Rregullimin ngritës mFRR.

Aktivizimi brenda një periodë të Shlyerjes (j):

TSO MR do të kompensojë TSO LR për koston e kapacitetit të rezervuar dhe koston e energjisë së livruar për periodën përkatëse sipas formulës:

$$P_{agesaR_{mFRR_Ngritës}} = \sum_j K_{R_{mFRR_Ngrites(j)}} * \zeta_{K_{mFRR_Ngrites(j)}} + \sum_j E_{L_{mFRR_Ngritës(j)}} * \zeta_{E_{mFRR_Ngritës(j)}}$$

Ku :

$K_{R_{mFRR_Ngritës}}$

Kapaciteti i rezervuar për rregullimin ngritës sipas kontratës që TSO LR ka me POSH;

$\zeta_{K_{mFRR_Ngritës}}$

Çmimi për kapacitetin e rezervuar për rregullimin ngritës sipas kontratës që TSO LR me POSH;

$E_{L_{mFRR_Ngritës}}$

Energjia e livruar gjatë aktivizimit të rregullimit ngritës gjatë një periode të Shlyerjes (j);

$\zeta_{E_{mFRR_Ngritës}}$

Çmimi i energjisë për kapacitetin e aktivizuar për rregullimin ngritës sipas kontratës me POSH;

j

Numri i periodave të Shlyerjes në muaj në të cilat ka pasur aktivizim të mFRR.

d. Rregullimin zbritës mFRR.

Aktivizimi brenda një periode të Shlyerjes (j):

TSO MR do të kompensohet nga TSO LR për koston e energjisë së livruar duke i zbritur koston e kapacitetit të rezervuar për periodën përkatëse sipas formulës:

$$P_{agesaR_{mFRR_Zbritës}} = \sum_j E_{L_{mFRR_Zbritës(j)}} * \zeta_{E_{mFRR_Zbritës(j)}} - \sum_j K_{R_{mFRR_Zbritës(j)}} * \zeta_{K_{mFRR_Zbrite(j)}}$$

Ku :

$K_{R_{mFRR_Zbritës}}$

Kapaciteti i rezervuar për rregullin zbritës sipas kontratës që TSO LR ka me POSH;

$\zeta_{K_{mFRR_Zbritës}}$

Çmimi për kapacitetin e rezervuar për rregullimin zbritës sipas kontratës që TSO LR ka me POSH;

$E_{L_{mFRR_Zbritës}}$

Energjia e livruar gjatë aktivizimit të rregullimit zbritës gjatë një periode të Shlyerjes (j);

$\zeta_{E_{mFRR_Zbrites}}$

Çmimi i energjisë për kapacitetin e aktivizuar për rregullimin zbritës sipas kontratës me POSH;

j

Numri i periodave të Shlyerjes në muaj në të cilat ka pasur aktivizim të mFRR.

Aktivizimi i këtij shërbimi bëhet sipas kërkesave të TSO-ve në përputhje me marrëveshjen e bllokut LFC AK me konfirmimin e palës tjetër.

11. Sigurimi dhe aktivizimi i Rezervës së Zëvendësimit - RR

- 11.1. Rezerva e zëvendësimit (RR) nuk është mandator për TSO-të.
- 11.2. Me qëllim të lirimit të mFRR, TSO mund të blejnë energji balancuese në treg në kohë reale për zëvendësimin e rezervës manuale.
- 11.3. Në rast se njëra nga TSO brenda bllokut LFC e disponon rezervën e zëvendësimit (RR) atëherë mund të ia ofrojë palës tjetër me marrëveshje. Në marrëveshje definohet mënyra e aktivizimit dhe kompensimit.
- 11.4. Secila TSO brenda bllokut LFC AK ka të drejtë të zbatojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR ndërmjet zonave LFC brenda bllokut LFC AK dhe ndërmjet blloqeve LFC. Për ketë qëllim duhet të bëhet një marrëveshje ndërkufitare aktivizimit të RR.

12. Shkëmbimi i informacioneve për aktivizimin e aFRR:

- 12.1. Për shërbimet e aFRR-së, kërkohet të shkëmbehen të dhëna në kohë reale dhe ex-post për Shlyerje.
- 12.2. Shkëmbimi i informacionit do të bëhet përmes komunikimit në kohë reale.
 - 12.2.1. Parametrat e mëposhtëm duhet të komunikohen ndërmjet TSO dhe POSH të aFRR në kohë reale në bazë të 4 sekondave:
 - **ΔP_{sec} (kërkesë kontrolli për POSH):** Kjo është kërkesa e kontrollit (MW) që TSO pranues i rezervës do t'i kérkojë secilit prej POSH të saj individualisht;
 - **Sinjali i kthimit të ΔP_{sec} :** Ofruesi aFRR dërgon sinjalin përsëri në TSO Pranues i rezervës (pasqyrë e sinjalit të marrë) për të kontrolluar nëse sinjali është marrë në mënyrë korrekte;
 - **P_{matur}**: Matja (MW) e (bruto nëse vlera neto nuk mund të matet) energjisë së prodhuar neto në pikën livrimit;

- **P_{ref} / P_{baseline}**: Fuqia (në MW) që do të kishte injektuar / konsumuar pa aktivizimin e shërbimeve aFRR. Baza fillestare duhet të dërgohet 60 sekonda më parë;
- **P_{sec}**: Numri i MW i ΔPsec që i atribuohen një pikë livrimi i ose një grupi të pikave të livrimit.

13. Shkëmbimi i informacionit për aktivizimin e mFRR

- 13.1. Shkëmbimi i informacionit për aktivizimin e mFRR do të bëhet përmes komunikimit në kohë reale.
- 13.2. Për aktivizimin e mFRR ndërkufitare, TSO MR përmes komunikimit në kohë reale njofton TSO LR jo më vonë se 15 minuta para kohës së aktivizimit për nevojën e paraqitur të aktivizimit të kapacitetit mFRR: TSO MR njofton TSO LR si në vijim:
 - a) Kapacetetin mFRR në MW që pretendon ta aktivizojë për aktivizim të rezervës;
 - b) Kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit të aktivizimit të kapacitetit mFRR;
 - c) Njësitë gjeneruese që do të aktivizoj.
- 13.3. TSO MR dhe TSO LR jo më vonë se 15 minuta para kohës së aktivizimit duhet të definojnë kapacetetin e lirë ndërkufitarë që mund të shfrytëzohet për aktivizimin e kapacitetit mFRR për periodën e aktivizimit të kapacitetit mFRR.
- 13.4. Për të aktivizuar një kapacitet të kontraktuar mFRR, TSO MR njofton POSH dhe TSO LR me një mesazh elektronik jo më vonë se 13 minuta para kohës së aktivizimit ku specifikohet:
 - a) Kapaceteti ndërkufitar që do të shfrytëzohet për aktivizimin e kapacitetit mFRR;
 - b) Koha e fillimit dhe koha e përfundimit të aktivizimit të kapacitetit mFRR;
 - c) Kapaceteti i kërkuar për aktivizim në MW jo më i madh se kapaceteti i lirë ndërkufitar për periodën kohore të aktivizimit.
- 13.5. POSH jo më vonë se 8 minuta para kohës së fillimit të aktivizimit duhet ti dërgojë TSO MR dhe TSO LR mesazh elektronik ku theksohet se:
 - i. POSH pranon dhe konfirmon aktivizimin e mFRR sipas kërkesës së TSO MR me informacionet si në vijim:
 - a) Listën e njësive balancuese që do të aktivizohen;

- b) Kapacitetin që do të aktivizojë për secilën njësi balancuese;
- c) Trajktoren e ngritjes se fuqisë (Ramp Rate) për secilën njësi balancuese.

POSH me këtë rast do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ofrimin e shërbimit sipas kapacitetit të kërkuar të rezervës manuale pa veprime të mëtejshme nga TSO MR.

- ii. POSH nuk mund të aktivizoj një pjesë ose në tërësi kapacitetin e rezervës manuale të kërkuar nga TSO MR, atëherë POSH duhet të specifikoj arsyet e refuzimit:
 - a) Kapaciteti në tërësi nuk është në dispozicion për shkak të ndërprerjes së detyruar të njësisë balancuese;
 - b) Kapaciteti pjesërisht nuk është në dispozicion për shkak të ndërprerjes së detyruar të njësisë balancuese.

Në rast të aktivizimit të pjesshëm të kapacitetit të kërkuar nga TSO MR, POSH ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për furnizimin e pjesës së kapacitetit të rezervës në dispozicion pa veprime të mëtejshme nga TSO MR.

- 13.6. Për çdo vazhdim të aktivizimit apo ndryshimit të aktivizimit procedura e komunikimit duhet të përsëritet.
- 13.7. Asnjë njoftim apo komunikim nuk do të konsiderohet si i realizuar përvèç rastit nëse konfirmohet pranimi i të njëjtit nga palët dhe Operatorët e Sistemeve përkatëse.
- 13.8. Shkëmbimi i informatave në lidhje me aktivimin e kapacitetit mFRR do t'u drejtohet personave përkatës kontaktues të TSO MR, TSO LR dhe POSH, siç përfkufizohet në Shtojcën 2.
- 13.9. Komunikimi në kohë reale do të bëhet përmes postës elektronike, telefonit apo Faksit. Në rast se komunikimi bëhet me telefon atëherë biseda duhet të regjistrohet nga KOSTT dhe OST.

14. Mbajtja e parametrave të FRCE sipas targeteve të vendosura për bllokun LFC

- 14.1. Në përputhje me Nenin 128 të SO GL, të dy TSO-të e bllokut LFC AK duhet të bëjnë përpjekje që të jenë në përputhshmëri me parametrat synues të FRCE të vendosura për bllokun LFC AK.

- 14.2. Numri i intervaleve kohore për vit jashtë brezit targetues të FRCE të Nivelit 1 duhet të jetë brendi i intervalit kohor të barabartë me kohën për restaurimin e frekuencës, respektivisht duhet të jetë më i vogël se 30% të intervaleve kohore për atë vit.
- 14.3. Numri i intervaleve kohore për vit jashtë brezit të FRCE sipas nivelit 2 brenda intervalit kohor të këtia të barabartë me kohën për restaurimin e frekuencës duhet të jetë më i vogël se 5% të intervaleve kohore ne vite.
- 14.4. Vlerat e FRCE për rivelin 1 dhe nivelin 2 llogariten në baza vjetore në zonën sinkrone të Evropës Qendrore (SA CE).
- 14.5. Monitoruesi i bllokut llogarit parametrat synues të zonave LFC përkatëse brenda bllokut LFC AK. Mënyra e llogaritjes është vendosur në shtojcën 3.
- 14.6. Secila TSO në bllokun LFC AK është përgjegjëse që të realizojë rregullimin fuqitë frekuencë me qëllim të plotësimit të parametrave synues FRCE në përputhje me Nenin 4.5 të Marrëveshjes së Bllokut AK.
- 14.7. Monitoruesi i bllokut do të jetë përgjegjës për raportimin tek anëtarët e bllokut LFC AK çdo tre mua dhe identifikimin e çdo shkelje të parametrave synues të FRCE.
- 14.8. Secila TSO në bllokun LFC AK është përgjegjëse që të jetë në përputhshmëri me rregullat përdimensionsionimin e rezervave për restaurimin e frekuencës (këtu e tutje referohet si "F1 R") në përputhje me Nenin 4.9 të Marrëveshjes së Bllokut AK.
- 14.9. Monitoruesi i bllokut LFC AK është përgjegjës për identifikimin e çfarëdo shkelje të limiteve të FRCE si ne poshtë:
 - 14.9.1. Në qoftë mesata ja 1-minutëshe e FRCE të bllokut LFC AK është mbi brezin e FRCE Nivelit 2 së shaku gjatë 15 minutash.
 - 14.9.2. Në rastet kur FRCE e bllokut LFC AK tejkalon 25% të incidentit referent të zonës sinkrone përmë gjatë se 30 minuta të njëpasnjëshme.
- 14.10. Në momentin e identifikimit të çfarëdo shkelje të limiteve, monitoruesi i bllokut LFC AK do të informojë Palen tjetër dhe bashkërisht me të do të implementoj veprimet e koordinuara për zvogëlimin e FRCE.

- 14.11. Secila Palë është përgjegjëse për aktivizimin e masave vetjake që ka në dispozicion të saj me qëllim të zvogëlimit të FRCE në zonën LFC – që do të thotë aktivizimin e FRR, RR në qoftë se aplikohet. Shërbimin e ndihmës të Ndërsjellë Emergjente në qoftë se aplikohet, Asistencën për procedurën e fuqisë aktive etj.
- 14.12. Në qoftë se gjithë secila prej Palëve ende nuk është në gjendje të zvogëlojë FRCE, Pala tjetër duhet të informohet. Pala e ndikuar mund të kërkojë nga Pala tjetër aktivizimin e masave shtesë (në qoftë se janë të disponueshme) me qëllim të ndihmës në zvogëlimin e devijimit te FRCE të Palës që është në shkelje.
- 14.13. Masat shtesë për reduktimin e FRCE të bllokut LFC AK aktivizohen në përputhje me Nenin 4.15 të Marrëveshjes së Bllokut AK. Kostot e masave të aktivizuara shtesë mbulohen nga TSO MR.

15. Masat e mëtejshme me qëllim të zvogëlimit të FRCE

- 15.1. Në qoftë se veprimet që kanë për qëllim zvogëlimin e devijimeve të FRCE siç theksohet në Nenin 4.7 të Marrëveshjes së Bllokut AK nuk janë të mjaftueshme dhe sasitë e kérkuara shtesë të rezervës siç theksohet në Nenin 4.11 të Marrëveshjes së Bllokut AK, nuk janë të disponueshme për blerje, atëherë secila TSO është përgjegjëse që të aktivizojë masat e mëtejme për zvogëlimin e devijimit në përputhje me vlerat e vendosura të FRCE duke kérkuar ndryshimin e prodhimit te fuqisë së njësive gjeneruese ose ndryshimin në konsum.
- 15.2. Për aktivizimin e masave shtesë do të përdoret modeli TSO-TSO. Masat shtesë mund të aktivizohen edhe jashtë bllokut LFC. Në këto raste Pala që bënë aktivizimin e masave konsiderohet si TSO LR. TSO MR është përgjegjëse për informimin e TSO LR, në qoftë se aplikohet.
- 15.3. Çdo kërkesë për aktivizim ndër-kufitar duhet të konfirmohet me shkrim nga TSO MR dhe nga TSO LR, në qoftë se aplikohet.
- 15.4. Secila Palë është e obliguar të ofrojë një sasi të dakordësuar të FRR në përputhje me Nenin 4.9 dhe Nenin 4.10 të Marrëveshjes së Bllokut AK. Në rast të harxhit të FRR në zonën LFC respektive, Pala duhet të blejë sasinë e kérkuar të rezervës. Në qoftë se rezerva nuk është e disponueshme, Pala respektive duhet të ndërmarrë masat e mëtejme, të balancimit të bllokut LFC që janë përcaktuar në shtojcën 4.

15.5. Pala që ka mungesë të FRR duhet të informojë Palën tjetër. Monitoruesi i bllokut LFC AK duhet të verifikojë nëse FRR e bllokut LFC AK është më tej e mjaftueshme. Në qoftë se monitoruesi i bllokut LFC AK vlerëson se FRR në bllokun LFC AK nuk është e mjaftueshme, Pala që ka mungesë të FRR duhet të shpallë alarm në EAS.

NË PRANINË E NJËRA TJETRËS, palët nënshkruajnë këtë procedurë në datën 13.10.2020.

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT sh.a.

Nga



Emri: Skerdi Drenova



OPERATORI
I SISTEMIT TE
TRANSMETIMIT

Titulli: Administrator

OPERATORI SISTEMI, TRANSANSMISIONI DHE TREGUT sh.a.

Nga



Emri: Ilir M. Shala



OPERATOR SISTEMI, TRANSANSMISIONI DHE TREGUT sh.a.
OPERATORI SISTEMI MD MARKET - TRADING - TRANSMISSION SYSTEMS
OPERATORI SISTEMI MD MARKET - TRADING - TRANSMISSION SYSTEMS

Titulli: Kryeshef Ekzekutiv

Shtojca 1 Sigurimi dhe aktivizimi i rezervave për balancim të sistemit

i. Sigurimi dhe aktivizimi i rezervës së Mbajtjes së Frekuencës - FCR

Rezerva e Mbajtjes së frekuencës (FCR) është rezervë qe aktivizohet automatikisht përmes rregulatorëve automatik të rregullimit që gjendet në centrale elektrike në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara. Rezerva aktivizohet plotësisht brenda 30 sec, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 min. Prokurimi i FCR bëhet në mënyrë të pavarur nga OST dhe KOSTT për zonat LFC përkatëse.

Sipas llogaritjes vjetore që bëhet nga ENTSO-E, kontributet e zonave LFC OST dhe KOSTT në rregullimin e frekuencës për vitin 2020 janë:

	Zona LFC OST	Zona LFC KOSTT
Kontributi i zonës LFC [MW]	8	6
Faktori K [MW/Hz]	75	50

Tabela 1. Kapaciteti i rezervës se restaurimit te frekuencës - FCR

Kontributi i zonës sinkrone është 3000 MW që është rezerva totale e këtij rregullimi për rrjetin sinkron të Evropës Kontinentale.

Kjo rezerve vlerësohet ne baza vjetore.

ii. Sigurimi dhe aktivizimi i rezervës automatike të restaurimit të sistemit - aFRR

Secili operator i sistemit transmetues në bllokun LFC AK duhet të implementoj procesin e restaurimit automatik të frekuencës (aFRR). Secila Palë duhet të përcaktojë rezervën automatike adekuate në atë mënyrë që të zvogëloj FRCE të TSO-së respektive.

Vlera e aFRR për zonat LFC OST dhe KOSTT do të vlerësohet periodikisht (ne baza vjetore).

Rezerva automatike e rregullimit është rezervë simetrike në dy kahjet. Për këtë qëllim vlera minimale e rezervës që secila TSO duhet ta sigurojë në kuadër të bllokut LFC caktohet sipas formulës empirike të dhënë në manualin e operimit të ENTSO-E:

$$R = \sqrt{aL_{\max} + b^2} - b$$

ku **a = 10**, **b = 150**, dhe **L_{max}** është vlera maksimale e ngarkesës.

Për vitin 2020 vlerat aFRR për te dy TSO ne kuadër të bllokut LFC AK janë:

	Zona LFC OST	Zona LFC KOSTT
Kapaciteti i rezervës për rritje te fuqisë/ zbritje te fuqisë	± 44 MW	± 37 MW

Tabela 2. Kërkesa për rregullim aFRR për zonat LFC OST dhe KOSTT

KOSTT dhe OST kanë një marrëveshje ndërmjet dy TSO-ve për këmbimin e rezervave automatike të rregullimit. Marrëveshja e këmbimit të rezervave automatike aktivizohet sipas modelit TSO-TSO.

Aktivizimi i rezervës automatike bëhet në kohë reale. KOSTT në mënyrë të vazhdueshme do të dërgojë sinjalin e FRCE nga SCADA e KOSTT në SCADA te OST.

Skema e funksionimit është dhëne ne fig.1.




Figura 1. Algoritmi i funksionimit të rezervës automatike ndërmjet KOSTT dhe OST

Për aktivizimin e rregullimit automatik ndërmjet KOSTT dhe OST të gjithë çelësat logjik duhet të jenë të kyçur " a=on, f=on, d=on, e=on". Pra në këtë mënyrë KOSTT dërgon për rregullim automatik për ngritje/zbritje të fuqisë.

Në rastin tjetër kur pozita e çelësave logjik është në këtë modë të operimit "a=on, f=on, d=off, e=on" atëherë të dy TSO punojnë të pavarura nga aspekti i rregullimit automatik.

KOSTT do ta dërgojë në mënyrë të vazhdueshme kërkesën për rregullim automatik çdo 4 sekonda nga moduli i AGC në sistemin e SCADA EMS në KOSTT te sistemi SCADA EMS në OST përkatësisht në modulin e AGC në OST.

Aktualisht të dy TSO (KOSTT dhe OST) kanë marrëveshje komerciale që OST t'i ofrojë KOSTT-it shërbime të rezervës automatike aFRR (Rregullimit Sekondar) në brezin $\pm 25\text{MW}$.

